

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6590
E premte, 22 prill 2022
çmimi 0.40 €

Senatorët amerikanë vizitojnë Kosovën, konfirmojnë përkrahjen e ShBA-së | FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

DEBATI NË PARLAMENTIN EVROPIAN: BE-ja FTOHET T'I MBAJË PREMTIMET NDAJ KOSOVËS



Në Komisionin e Parlamentit Evropian për Politikë të Jashtme është zhvilluar të enjten debat për draftin e raporteve për Kosovën dhe Serbinë. Për përmbajtjen e këtij raporti ka folur Viola von Cramon, raportuese për Kosovën, e cila ka theksuar se procesi i pajtimit në rajonin e Ballkanit Perëndimor nuk ka dhënë rezultate ende. Përfaqësuesi i Komisionit Evropian në këtë debat ka përsëritur se vlerësimi i Komisionit Evropian vazhdon të jetë se Kosova i ka përmbushur të gjitha kriteret për liberalizimin e vizave dhe se mbështetja nga Parlamenti Evropian në këtë drejtim mbetet kyçe

Shkruan:
Kudusi LAMA



RA KJO DEKË E U PAMË, N'AMERIKË! | FAQE 5



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA



OSMANI ME SHOQËRINË CIVILE: KRYEPROKURORI I SHTETIT DUHET TË KETË INTEGRITET TË DËSHMUAR PËRGJATË KARRIERËS

| FAQE 7

FEJTON

QË NJË KRIM TË VËRTETOHET, DUHET TË GJENDET LIDHJA E TË AKUZUARIT ME KRIMIN | F. 3

AKTUALE



SHBA-ja VENDOS SANKSIONE TË REJA NDAJ RUSISË | F. 2

STAFI SHËNDETËSOR KËRKON RITJE TË PAGAVE 50 PËR QIND DERI NË MIRATIMIN E LIGJIT TË PAGAVE | F. 4

EKONOMI



HAPET APLIKIMI PËR SHITESËN 100 EURO PËR PUNËTORËT E SEKTORIT PRIVAT | F. 8

MBAHET FORUMI EKONOMIK KOSOVË - AUSTRI, THEKSOHET BASHKËPUNIMI NË BIZNES | F. 8

SPORT

KRYETARI I PRISHTINËS PRET NË TAKIM DREJTUESIT E FFK-së | F. 11

RENOVA
PUTZ
Magedoni Xhepcisht - Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

Ukraina thotë se janë gjetur trupa me shenja torturash afër Kievit

KIEV, 21 PRILL - Trupat e nëntë civilëve, disa me shenja torture, janë gjetur në qytetin Borodyanka jashtë kryeqytetit ukrainas, Kiev, tha një zyrtar i lartë i policisë. “Këta njerëz u vranë nga pushtuesit dhe disa tregojnë shenja torture. Dua të theksoj se këta njerëz ishin civilë. Ushtria ruse me vetëdije qëllor civilë që nuk bënë asnjë

rezistencë”, njoftoi kreu i policisë në rajonin e Kievit, Andriy Niebytov.

Tërheqja e forcave ruse nga qytetet dhe fshatrat përreth Kievit la gjurmë të vrasjeve të civilëve, duke filluar me zbulimet në Buça, që kanë bërë që zyrtarët ukrainas ta akuzojnë Rusinë për gjenocid. Niebytov ka thënë se policia kishte zbuluar dy varre rreth

Borodyankas. “Në një varr, tre persona - duke përfshirë një vajzë 15 vjeçe - u zbuluan dhe në një varr të dytë u gjetën trupat e gjashtë personave. Të gjithë ata ishin vendas”, ka thënë ai. Autoritetet në Kiev thonë se qindra trupa civilësh të vrarë janë gjetur në zonat e kontrolluara nga forcat ruse rreth kryeqytetit që nga nisja e pushtimit më 24 shkurt.



ShBA-ja vendos sanksione të reja ndaj Ruisë



WASHINGTON, 21 PRILL - Shtetet e Bashkuara kanë njoftuar për raundin e ri të sanksioneve ndaj Ruisë për shkak të pushtimit të Ukrainës.

Sanksionet e reja kanë për shënjestër një bankë kyçe komerciale, Transkaptalbank, dhe “një rrjet global të më shumë se 40 individëve dhe entiteteve që udhëhiqen nga oligarku rus, Konstantin Malofeyev”.

Departamenti Amerikan i Thesarit tha se po shënjestron “kompanitë që operojnë në industrinë e monedhave

virtuale së Ruisë, që raportohet se është industria e tretë më e madhe në botë”, duke theksuar se ka “shënjestruar një kompani të monedhës virtuale”. Kompania e sanksionuar është BitRiver, që merret me Bitcoin, dhe dhjetë filialet e saj në Rusi. Përveç kësaj, Departamenti Amerikan i Shtetit ka vendosur kufizime të vizave për “635 shtetas rusë, të cilët janë të përfshirë në shtypjen e disidencës në Rusi dhe jashtë saj, të cilët kanë qenë të përfshirë në aktivitete të ndryshme që kërcënojnë integritetin

territorial të Ukrainës dhe kanë qenë të përfshirë në shkeljet e të drejtave të njeriut në burgje dhe në objekte jozyrtare paraburgimi në zonat e kontrolluara nga Rusia në rajonin ukrainas të Donbasit.

Po ashtu, Departamenti Amerikan i Shtetit ka vendosur kufizime të vizave edhe për tre zyrtarë rusë “të përfshirë në shkelje të rënda të të drejtave të njeriut dhe 17 individë që konsiderohen përgjegjës për minimin e demokracisë në Bjellorusi”, njoftoi Thesari Amerikan.

Hungaria do detaje nga BE-ja para se t'i vendosë sanksione Ruisë

BUDAPEST, 21 PRILL - Hungaria dëshiron t'i shohë detajet e një propozimi të Bashkimit Evropian për sanksione ndaj importeve të naftës dhe gazit rus para se të vendosë nëse do t'i bllokojë ato, tha të enjten shefi i kabinetit të kryeministrit, Viktor Orban.

Hungaria ka qenë e vendosur kundër një embargoje të gazit dhe naftës, për të cilën Budapesti ka thënë se do ta shkatërronte ekonominë hungareze.

Vendi importon nga Rusia rreth 80 për qind të gazit dhe 65 për qind të naftës që i nevojitet. Gjermania do ta ndalojë importin e naftës nga Rusia deri në fund të vitit, tha të mërkurë ministria e Jashtme gjermane,



Annalena Baerbock.

Kur u pyet në lidhje me komentet e Baerbockut dhe nëse Hungaria do të vërë veton ndaj sanksioneve të BE-së për naftën

dhe gazin rus, shefi i stafit të Orban Gergely Gulyas, tha: “Ne do të donim të shohim se çfarë lloj propozimesh janë në tryezë dhe nëse ka një alternativë për t'i

zëvendësuar burimet e ardhura nga Rusia”.

Gulyas shtoi se në lidhje me importet e gazit nuk kishte një alternativë të tillë në të ardhmen e parashikueshme. “Jo vetëm ekonomia hungareze, por edhe ajo gjermane do të rrënohej dhe do të rrëshqiste në një recesion të thellë pa gazin rus... kështu që çdo debat për këtë, apo moralizim, është i pakuptimtë”, tha ai. “As sa i përket naftës situata nuk është dukshëm më e favorshme, por atje ka më shumë alternativa”, shtoi ai.

Gulyas tha se do të duheshin disa muaj, ose deri në një vit dhe qindra miliarda forintë për t'i rregulluar rafineritë për t'u mundësuar atyre të përpunojnë naftë joruse. “Ne kemi nevojë

për vendime të përgjegjshme nëse duam të vendosim ndonjë sanksion. Ne duhet të tregojmë se nga mund t'i importojmë burimet e dhëna energjetike, në çfarë sasive... dhe kush do të paguajë për këtë. Ne nuk mund ta shohim këtë sot dhe kështu do të jini të papërgjegjshëm të flisni për këto sanksione shtesë”, tha Gulyas.

Rusia është furnizuesja më e madhe e naftës në Evropë, duke siguruar 26 për qind të importeve të naftës në BE në vitin 2020. Sanksionet e gazit shihen si zgjidhja e fundit në paketën e masave potenciale të energjisë të BE-së për shkak të varësisë së Evropës prej tij për përdorim industrial dhe ngrohjen e shtëpive.

Vuçiq: Nuk do të vendosim sanksione ndaj Ruisë

BEOGRAD, 21 PRILL - Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, ka thënë se, pavarësisht prej presioneve, Serbia nuk do t'i rrezikojë interesat kombëtare duke iu bashkuar sanksioneve perëndimore ndaj Ruisë për shkak të luftës në Ukrainë. Në një intervistë për “Financial

Times” më 21 prill, ai tha se Beogradi nuk “do të zgjedhë anë” pavarësisht prej thirrjeve nga Bashkimi Evropian që Serbia, si shtet kandidat për anëtarësim në bllok, t'i harmonizojë politikat e saj të jashtme me të Brukselit, përfshirë edhe sanksionet ndaj

Ruisë dhe presidentit rus, Vladimir Putin. “Ka bisedime për zgjedhje të anëve. Jo, ne e kemi anën tonë, interesat e Serbisë. Nëntëmbëdhjetë shtete të NATO-s na bombarduan në [më 1999] dhe vendosën sanksione ndaj nesh”, ka thënë Vuçiq.



“Ndërmarrje e Përbashkët Kriminale” apo luftë çlirimtare e Kosovës? (3)

Që një krim të vërtetohet, duhet të gjendet lidhja e të akuzuarit me krimin



Shkruan: Kudusi LAMA

Me misionin dhe veprimtarinë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës hapësira e botës ndërkombëtare dhe faktorët e saj politikë, shoqërorë, ligjorë, ushtarakë, qytetar dhe njerëzor, është njohur që në atë kohë kur zhvillohej lufta dhe është bërë pjesë e atij misioni dhe asaj lufte, sepse ka vlerësuar se ajo ushtri kishte një mision human, çlirimtar dhe njerëzor. Ndërsa sot pas dy dekadash, ajo luftë tentohet të emërtohet “Ndërmarrje e Përbashkët Kriminale”.

Dëgjojmë e lexojmë edhe analiza e analistë, që mendojnë e shprehen se krimet e pretenduara të shpallura nga ajo prokurori e gjykatë speciale, mund të vërtetohen. Është e habitshme të dëgjosh të tilla mendime e analiza edhe nga juristë, sepse, që një krim të vërtetohet, duhet të gjendet lidhja e të akuzuarit me krimin. Kurse të akuzuarit në rastin tonë thjeshtë akuzohen pse kanë qenë në funksione në Shtabin e Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ata as kanë urdhëruar një krim, as kanë dijeni se është kryer një krim, as kanë marrë pjesë në kryerjen e një krimi, as kanë parë të jetë kryer një krim, as kanë marrë raport se është kryer një krim, ata thjeshtë akuzohen se kanë kryer detyrën e tyre në luftë. Pasi sipas kësaj logjike lind e drejta të akuzohet çdo drejtues në çdo institucion, organizatë ose shtet, për çdo veprim që mund të kryej një anëtar i tij. Sipas kësaj logjike, nëse një qytetar i Kosovës kryen një krim diku në territorin e Kosovës ose jashtë tij, duhet marrë i pandehur presidenti, kryetari i parlamentarit ose kryeministri i Kosovës. Kjo është

logjika më e pakuptimtë. Kështu ka ndodhur me katër anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Prandaj ata që merren me analiza janë të lutur të thirren në logjikën dhe ligjin, jo thjeshtë ta analizojnë çështjen pa e lexuar as aktakuzën dhe pa e ditur se cili ka qenë pozicioni i këtyre burrave gjatë luftës dhe si ka funksionuar procesi luftarak, kur Kosova ishte e mbushur pëllëmbë e policë, ushtarë, paramilitarë, kriminelë e civilë serbë të armatosur. Secili të vihet përballë kësaj pamjeje dhe të analizojë veprimtarinë e djemve në luftë.

I bëj këto kërkesa për të gjithë ata që duan të jenë të drejtë dhe të ndershëm në këtë botë. Për të gjithë ata që të keqen e tjetrit e konsiderojnë të keqe edhe për veten. Këto kërkesa që bëj, nuk vlejné vetëm për serbët dhe ata që u janë edhe sot besnikë atyre, nuk vlejné për ata që janë aktualisht në shërbim të serbëve dhe nuk vlejné as për ata që thjeshtë kanë urrejtje për Hashim Thaçin, Kadri Veselin, Jakup Krasniqin, Rexhep Selimin, Hysni Gucatin e Nasim Haradinajn, e të tjerë luftëtarë që kanë kaluar e do të kalojnë në atë portë të pandershmërisë e të padrejtësisë më të pakuptimtë të kohës moderne.

Nuk duhet të luhet me historinë për hatër të politikës

Është vlerë kombëtare të vëmë në vëmendje të gjithë botës faktin që, nuk është normale të shkojmë akoma me mendimin se mund të luhet me historinë për hatër të politikës. Dhe të bëjmë të qartë se

ne shqiptarët nuk do të lejojmë më që të bëhet politikë me fatin tonë, me historinë tonë, me hapësirat tona territoriale dhe me të ardhmen tonë. Këtë mendoj në radhë të parë duhet ta bëjmë të qartë për vete dhe në të pastajmen për të gjithë të tjerët. Për të krijuar te të gjithë bindjen e plotë se nuk duhet e nuk do të lejojmë që të ndyhet lufta çlirimtare e Kosovës dhe ushtria që barti atë.

Ata që rrëmbejnë armët për të fituar lirinë nuk marrin lirinë e të tjerëve

Në aktakuzë pretendohet se nga marsi i vitit 1998 deri në shtator të 1999, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi, Jakup Krasniqi dhe anëtar të tjerë të “ndërmarrjes së përbashkët kriminale kanë ndarë qëllimin e njëjtë për të marrë dhe ushtruar kontrollin në gjithë Kosovën me të gjitha mjetet, përfshirë edhe frikësimin, keqtrajtimin, ushtrimin e dhunës dhe eliminimin e atyre që i konsideronin kundërshtarë”. Nuk e kuptoj, a e kanë të qartë ata që kanë përpiluar këtë akuzë, kush konsiderohet luftë çlirimtare, si dhe cilat janë parimet e një lufte çlirimtare? Mendoj se të ngresh një akuzë, pse luftëtarët duan të çlirojnë vetveten dhe atdheun e popullin e tyre me luftë prej një pushtuesi, është loja më e rrezikshme që bën një institucion me forcën e tij. E pikërisht këtë bëri Këshilli i Europës dhe këtë po bën kjo prokurori në dëm të luftës e të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Duke ngritur aktakuzë me këtë emërtesë false dhe të pathemeltë, prokurorët janë përpjekur t'i ndërtojnë akuzat sikur kanë përballë kriminelë të nivelit të

ultë, jo udhëheqës të një ushtrie të madhe, që ka bërë një luftë heroike e ka çliruar popullin dhe atdheun e vet. Prokurorët shkojnë deri atje, sa të shkruajnë e pretendojnë se Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi, personalisht kanë marrë pjesë në kërcënime, marrje në pyetje, keqtrajtimin dhe ndalimin e kundërshtarëve. Sa të ultë këta prokurorë, sa nivel i ultë, sa të panivel duken që në këtë akuzë, që i trajton udhëheqësit si të ishin hetues krimesh, policë rrugorë, gardianë burgu a roje portash.

Jo more zotërinj, nuk ishin të tillë udhëheqësit tanë! Ata ishin liderë me parime. Ata ishin çlirimtarë, se për këtë i kishin rrëmbyer armët, prandaj edhe nuk ishte në misionin e tyre të merrnin lirinë e të tjerëve.

Por duket se këta të cilët merren me këtë çështje, janë përzgjedhur që të njohin vetëm interesat e atyre që i kanë vënë në detyra, të njohin vetëm interesat e Serbisë dhe të atyre që i paguajnë më shumë. Prandaj shihet se ata nuk kanë as konceptin e atdheut, luftës për liri, marrjen e përgjegjësive për atdheun etj. Sepse po të kishin vetëm një koncept të thjeshtë do ta vinin veten në rolin e këtyre burrave të akuzuar në kushtet e luftës për liri dhe të vlerësonin se si do t'i kryenin detyrat e tyre e a do të kishin kohë të merreshin edhe me ato budallallëqet me të cilat i ngarkojnë burrat e udhëheqës së luftës në këtë aktakuzë të pathemeltë.

Akuza jashtë logjikës së kohës së luftës

Për luftëtarët bëhen akuza se kanë bërë transferime, ndalime dhe burgosje të njerëzve të ndryshëm, kur ata në kohën kur luftonin e për të cilën akuzohen, nuk kishin mundësi të siguronin strehime për luftëtarët, nuk kishin mundësi të siguronin ushqime për luftëtarët, nuk kishin mundësi të bënin transportime për luftëtarët e për të furnizuar frontet e luftës me armatime, municione e pajisje luftarake, jo më të kujtoheshin për të siguruar këto elementë për të ndaluar. Por ja që ai i cili ka mundësi të akuzojë, mund të bëjë edhe akuza të tilla, që janë krejt jashtë logjikës së asaj kohe, pjesë e të cilës kam qenë dhe e kam përjetuar me të gjitha shqetësimet që ka bartë, prandaj edhe më duken shumë banale të gjitha ato akuza që u ngarkohen luftëtarëve, duke vënë pesha të tilla vetëm pse kanë mundësi ta bëjnë, pavarësisht si është e vërteta.

Krime të supozuara apo krime të ndodhura?

Akuzat bëhen për krime të supozuara, që mund të ketë bërë një luftëtar diku në hapësirat e Kosovës, të Shqipërisë, të Gjermanisë, Zvicrës, Francës, Suedisë, Norvegjisë, Finlandës, Italisë, SHBA-ve, Australisë, Zelandës së Re ... e diku tjetër në gjithë hapësirat europiane e botërore, ku kjo ushtri e lavdishme ka pasur bazat e saj dhe ky Shtab i Përgjithshëm i ka udhëhequr ato baza me shumë përgjegjësi dhe me shumë korrektësi ligjore. A ka logjikë të mbahet përgjegjësi për veprimet e një ushtari në frontin e luftës, pasi ai edhe mund të çmendet e mund të bëjë veprime të pa logjikshme? Po arsyetohet sikur krimet të jenë të vërtetuara, jo të supozuara siç i paraqet aktakuzat, kur thotë: se të pandehurit “si eprorë, janë përgjegjës për krimet e kryera nga vartësit e tyre. Ata dinin arsyet se krimet e paraqitura në këtë aktakuzë, do të kryheshin ose ishin kryer nga vartësit e tyre dhe dështuan të ndërmarrin veprimet e duhura që të parandalonin krimet e tilla ose të ndëshkonin kryerësit e këtyre krimeve”. Pra, ata e dinin, sepse kështu supozon prokurori, ani pse nuk ka asnjë dëshmi për ta vërtetuar këtë. Por thjeshtë prokurori pretendon se ky ose këto krime janë kryer dhe janë kryer patjetër nga një luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe se ky luftëtar më parë ka vënë në dijeni shtabin e përgjithshëm e pastaj ka kryer krimin që ka dëshiruar. A ka një shembull si ky në historinë botërore? A është në gjendje të japë sqarime prokurori për këtë? Mendoj se të ngresh supozime të tilla të pathemelta dhe të marrësh burrat e shtetit pas hekurave vetëm pse duhet të likuidohen nga politika për të përkëdhelur Serbinë, ky është krim nazist. Ky lloj krimi nuk e ka shokun.

Që të pretendosh në këtë mënyrë, duhet të kesh të dokumentuar krimin e kryer, jo të supozosh se është kryer një krim. Duhet të kesh pas hekurave kryesin e krimin, i cili të ketë deklaruar se ka marrë urdhër nga instanca më e lartë për të kryer krimin. Dhe pasi ta kesh pas hekurave urdhëruesin e kryerjes së krimin, mund të ecet deri në krerët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe të futen edhe ata pas hekurave të burgut e të marrin dënimin që meritojnë. Kurse në rastin e kësaj gjykate kemi një krim të supozuar, një kryes krimi pa emër, një urdhërues të panjohur, por përgjegjës udhëheqësit e luftës, të cilët kanë zbatuar me luftëtarët parimet më të spikatura të sjelljes e veprimit të ushtarit në luftë. (Vijon)



Debati në Parlamentin Evropian: BE-ja ftohet t'i mbajë premtimet ndaj Kosovës

Në Komisionin e Parlamentit Evropian për politikë të jashtme është zhvilluar të enjten debati për draftin e raporteve për Kosovën dhe Serbinë. Për përmbajtjen e këtij raporti ka folur Viola von Cramon, raportuese për Kosovën, e cila ka theksuar se procesi i pajtimit në rajonin e Ballkanit Perëndimor nuk ka dhënë rezultate ende. Përfaqësuesi i Komisionit Evropian në këtë debat ka përsëritur se vlerësimi i Komisionit Evropian vazhdon të jetë se Kosova i ka përmbushur të gjitha kriteret për liberalizimin e vizave dhe se mbështetja nga Parlamenti Evropian në këtë drejtim mbetet kyçe

PRISHTINË, 21 PRILL - Në Komisionin e Parlamentit Evropian për politikë të jashtme është zhvilluar të enjten debati për draftin e raporteve për Kosovën dhe Serbinë. Për përmbajtjen e këtij raporti ka folur Viola von Cramon, raportuese për Kosovën. Disa folës në debatin e së enjtes kanë shprehur mirënjohje për shpejtësinë, me të cilën Kosova kishte mbështetur sanksionet e BE-së ndaj Ruisë dhe kishte dënuar agresionin e Ruisë ndaj Ukrainës.

Në debat kanë folur edhe përfaqësuesit e Komisionit

Evropian dhe ata të shërbimit të Jashtëm të BE-së.

Vasilis Maragos nga Komisioni Evropian ka shprehur mirënjohje për qëndrimet e Kosovës rreth luftës në Ukrainë. Ai ka përshëndetur në veçanti edhe pjesëmarrjen e kryeministrit Albin Kurti në konferencën e donatorëve për Ukrainën.

Maragos ka paralajmëruar se Komisioni do ta ndihmojë Kosovën për t'u përballur me pasojat ekonomike. Në mënyrë të veçantë Maragos ka përmendur nevojën për investime në sektorin e energjisë duke e quajtur krizën e

fundit të furnizimit me energji në Kosovë, si alarm për t'u zgjuar nga gjumi.

Përfaqësuesi i Komisionit Evropian në këtë debat ka përsëritur se vlerësimi i Komisionit Evropian vazhdon të jetë se Kosova i ka përmbushur të gjitha kriteret për liberalizimin e vizave dhe se mbështetja nga Parlamenti Evropian në këtë drejtim mbetet kyçe.

Elsa Fenet nga shërbimi i veprimit të Jashtëm të BE-së (EEAS), po ashtu, ka vlerësuar qëndrimet e Kosovës rreth luftës në Ukrainë. Ajo ka thënë se Kosova formalisht

nuk është e obliguar që t'u përshtatet qëndrimeve të BE-së në politikën e jashtme, por gjithsesi një përshtatje e tillë është e mirëseardhur. Ajo ka theksuar se Kosova do të duhet të tregojë më shumë fleksibilitet në bashkëpunimin rajonal.

Sa i përket dialogut, ka thënë se situata gjeopolitike e bën normalizimin e raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë më të nevojshëm.

Deputeti kroat Tonino Piculla ka kërkuar nga BE-ja që të dëshmojë përkushtim ndaj Kosovës. "Roli ynë në Kosovë është kyç, por ne kur kërkojmë përmbushje të kushteve, duhet ta dëshmojmë shembullin tonë - përkushtimin. Është e papranueshme që BE-ja ende nuk i ka liberalizuar vizat për qytetarët e Kosovës", ka thënë ai.

Raportuesja Von Cramon në fund të debatit ka bërë ftesë që, në kohën kur fokusi është në agresionin e Ruisë ndaj Ukrainës,

të mos harrohet se procesi i pajtimit në rajonin e Ballkanit Perëndimor nuk ka dhënë rezultate ende. Ajo ka rikujtuar se në Kosovë edhe sot mund të shihen traumat nga lufta.

Në debatin për raportin për Serbinë është shprehur keqardhje për qëndrimet e saj rreth luftës në Ukrainë dhe kjo është parë si largim i Serbisë nga aspiratat e saj evropiane. Disa deputetë kanë përmendur edhe pasojat të rënda për Serbinë nëse nuk dëshmon se dëshiron t'i respektojë vlerat evropiane.

Shumë deputetë kanë thënë se "ka kaluar koha kur kanë mundur të bëhen balancime të qëndrimeve dhe tash Serbia, sikur secili shtet tjetër evropian, duhet të vendosë se në cilën anë dëshiron të jetë".

Edhe raportuesi i Parlamentit Evropian për Serbinë, Vladimir Bilić, ka kërkuar që Beogradi t'i mbështesë qëndrimet e BE-së. "Shtetet sovraane miratojnë

Stafi shëndetësor kërkon rritje të pagave 50 për qind deri në miratimin e Ligjit të Pagave

PRISHTINË, 21 PRILL (ER) - Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës ka kërkuar rritje pagash prej 50-përqindësh deri në miratimin e Ligjit të Pagave dhe pjesëmarrje në grupin punues për hartimin e Ligjit të Pagave. Në një adresim drejtuar kryeministrit Albin Kurti dhe

ministrit të Shëndetësisë, Rifat Latifi, FSSHK-ja është ankuar për gjendjen e rëndë të punëtorëve shëndetësorë.

Në letrën drejtuar Kurtit, FSSHK-ja ka paralajmëruar veprime sindikale nëse s'merrem masa nga qeveria. "Z. kryeministër, pa dashur ta zgjas më shumë, gjendja e

popullatës dhe punëtorëve shëndetësorë është shumë e keqe, e cila faktohet në pritjet që duhet të bëhen, andaj intervenimi juaj duhet të jetë i shpejtë dhe konkret. Çdo pasojë e mosveprimit adresën e ka te qeveria juaj", thuhet në letrën e Blerim Sylës, kryetarit në detyrë i FSSHK-së.



Senatorët amerikanë vizitojnë Kosovën, konfirmojnë përkrahjen e ShBA-së

PRISHTINË, 21 PRILL (ER) - Tre senatorë amerikanë, Chris Murphy, Thom Tillis dhe Jeanne Shaheen, kanë ardhur për vizitë në Kosovë nga Sarajeva, pasi kanë përfunduar vizitën në Beograd. Senatorët amerikanë kanë takuar të enjten presidenten Vjosa Osmani dhe kryeministrin Albin Kurti.

Osmani pas takimit që ka pasur me tre senatorët amerikanë, ka mbajtur një konferencë për medie, duke bërë me dije se i ka

informuar ata për "rolin destruktiv të Serbisë në rajon". "Nuk është sekret se rendi i sigurisë në Evropë është nën kërcënim. Ka pasur dhe ka interesim nga Rusia që ta destabilizojë kontinentin dhe rajonin tonë. I informova mysafirët tanë nga Senati i ShBA-së për rolin destruktiv që Serbia po vazhdon ta luajë në rajonin tonë si aleat i Rusisë, si një përpjekje për ta tërhequr rajonin tonë drejt së kaluarës", ka deklaruar ajo.

Por, Osmani pohoi se beson që këto ndikime do të ndalen nga populli i Kosovës për dy arsye. "E para, sepse ky është vullnet i popullit të Kosovës, si populli më pro amerikan dhe pro NATO-s në botë. E dyta, kam besim të plotë se kemi treguar deri më tani se kur punojmë së bashku me ShBA-në, mund të arrijmë gjithçka", ka theksuar Osmani.

Presidentja ka pohuar se do të punojnë edhe më tutje për ta forcuar demokracinë, teksa ka

shtuar se Kosova është një ndër storiet më të mëdha të suksesit për ShBA-në.

Senatorja amerikane Jeanne Shaheen ka theksuar se janë këtu, sepse mendojnë se është shumë e rëndësishme që në Senat ta shfaqin përkrahjen mbipartiake se çka po ndodh në Kosovë. "Ne punojmë së bashku për t'i përkrahur përpjekjet e shteteve si Kosova që janë të interesuar që të anëtarësohen në NATO. Ne ndajmë shqetësimet për

situatën e sigurisë në rajon dhe arsyeja që shkuam në Bondsteel ishte që të marrim informacione nga KFOR-i lidhur me sigurinë. Ne do të vazhdojmë të punojmë së bashku në idetë dhe sfidat, veçanërisht në ambientin e sigurisë në Evropë pas agresionit në Ukrainë. Nuk dëshirojmë që një gjë e tillë të ndodhë diku tjetër në Evropë dhe dëshirojmë që ta shohim se ka marrë fund", ka deklaruar Shaheen.



qëndrime sovraane, por edhe mbajnë përgjegjësi për qëndrimet e tilla" ka thënë Biliçik, duke shprehur pritjet e tij që Serbia t'i mbështesë qëndrimet e BE-së.

Michael Muler nga Komisioni Evropian ka thënë gjatë këtij debati se qëndrimet e Serbisë sa i përket agresionit të Rusisë ndaj Ukrainës do të merren në konsideratë kur të vendoset për

hapat në procesin e zgjerimit.

Elsa Fenet nga EEAS ka thënë se, ndonëse Serbia ka mbështetur disa qëndrime të BE-së, siç janë votimet në OKB, ende nuk e ka mbështetur asnjë sanksion ndaj Rusisë për agresionin kundër Ukrainës. Ajo ka thënë se kanë vazhduar kontaktet politike mes Serbisë dhe Rusisë, përfshirë edhe me ata që i ka quajtur "persona

kundërthënës". Po ashtu, ajo ka tërhequr vërejtjen se fushata dezinformuese ruse në Serbi vazhdon të jetë e pranishme.

Viola Von Cramon ka përhëndetur përmbajtjen e raportit për Serbinë, por e ka kritikuar grupin e Partive Popullore Evropiane (EPP) në Parlamentin Evropian duke e quajtur si "zonë e sigurt për

interesat e partisë së presidentit Vuçiq".

Deputeti nga Kroacia, nga radhët e grupimit Socialist dhe Demokrat, Tonino Piculla, ka thënë se Serbia nuk po e zbaton në praktikë obligimin për bashkëpunim rajonal dhe fqinjësi të mirë. Ai ka thënë se BE-ja nuk mund të tolerojë më kalkulime rreth standardeve dhe vlerave të saj.

Serbinë disa deputetë e kanë ftuar edhe që t'i hapë arkivat e ish-shërbimit sekret komunist UDB-së.

Raportet për Kosovën dhe Serbinë, sikur edhe për vendet e tjera të rajonit të Ballkanit Perëndimor, do të votohen në mesin e qershorit në Komisionin e Politikës së Jashtme, ndërsa në seancë plenare në muajin korrik.

Më 28 prill Kuvendi mban seancë, në rend dite Komisioni Hetimor për Krizën Energjetike

PRISHTINË, 21 PRILL (ER) - Më 28 prill, në orën 10:00, Kuvendi i Kosovës do ta mbajë seancën plenare të radhës. Kështu ka vendosur kryesia e Kuvendit në mbledhjen e përbashkët me kryetarë të grupeve parlamentare, të drejtuar nga kryeparlamentari Glauk Konjufca. Pas shterimit të pikave të zakonshme, deklarimeve

jashtë rendit të ditës dhe pyetjeve parlamentare, në rend dite do të jetë propozimi i 40 deputetëve për caktimin e Komisionit Hetimor Parlamentar lidhur me menaxhimin e krizës energjetike nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Më pas pritet të bëhet shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbrojtjen e sekreteve tregtare, për të vijuar

me zgjedhjen e një anëtari të bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga radhët e komuniteteve të tjera joshumicë, si dhe të tre anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Seanca pritet të përmbyllet me formimin e Organit Përzgjedhës të Pavarur për përzgjedhjen e anëtarëve në Organin Shqyrtues të Prokurimit.



RA KJO DEKË E U PAMË, N'AMERIKË!



**Behxhet Sh. SHALA -
BAJGORA**

Në përkujtim të lavdisë dhe dyfytërisë: Te popujt që e kanë të theksuar kompleksin e inferioritetit e që tërë jetën e kanë të përshkruar në folklor, reputacioni, besueshmëria, qëndrueshmëria, cilësia e të punuarit dhe të vepruarit në politikë dhe jo vetëm në politikë, si njësi matëse përcaktuese e kanë, jo sa e keni përkrahjen qytetare apo të votuesve, por se sa e keni përkrahjen e miqve ndërkombëtarë apo miqve të interesit. Që nga përfundimi i luftës beteja që është bërë midis pozitës dhe opozitës nuk është mbështetur në punën e bërë apo të pabërë, por sa jeni amerikanë, sa e keni përkrahjen e BE-së, me kënd jeni takuar dhe në çfarë niveli ndërkombëtar jeni takuar, çka ju kanë thënë këta miq dhe të tjera e që popujt e qytetëruar me këto broçkulla merren aq sa me borën e vitit të kaluar. Në kohën e ish-Jugosllavisë dhe Serbisë shqiptarët që kishin përkrahjen e tyre sepse ishin në shërbim të tyre jetonin pakrahasimisht më mirë se të tjerët që përndiqeshin për shkak të bindjeve politike dhe të drejtës për të jetuar në liri, sikur edhe të tjerët. Baca Adem Demaçi bëri thuaja 30 vjet burgje në llogoret e ish-Jugosllavisë dhe të Serbisë dhe, pasi doli nga një Burg i Vogël në një Burg të Madh të quajtur Kosovë, nuk e kishte përkrahjen as të ndërkombëtarëve dhe as të ashtuquajturve pacifistë të Kosovës për shkak se nuk pajtohej me një liri gjysmake sipas Kushtetutës së popave të Shën Exhidios, prandaj ishte cak i linçimit dhe pushkatimit medial të vazhdueshëm, sidomos pas kundërshtimit të Marrëveshjes së Rambujesë. E cilësonin si anti-amerikan, si anti-evropian, dogmat dhe kundër demokracisë që punon për të nxitur një luftë. Në periudhën pasi doli nga burgu në mesvitin e vitit 1990 e deri të shpërthimi i luftës në Kosovë, Baca Adem Demaçi u luftua pamëshirshëm, fillimisht nga shqiptarët me një të kaluar jugosllave dhe serbe që ishin përbiruar me shumë sukses dhe forcueshin në të ashtuquajturën lëvizje pacifiste, por edhe nga diplomatët e dorës së dytë, second hand, të cilët të të pashpresët dhe ata që nuk ishin në gjendje të

sakrifikonin asgjë për Kosovën, e gëzonin statusin e zotërave ku i varnin të gjitha shpresat, sikur një lypës që e shtrinë dorën. Ishte antologjik sulmi i ulët dhe i kurdisur se: "Adem Demaçi ia mbylli telefonin sekretares së shtetit, Medllin Ollbrajt..." për ta dëshmuar anti-amerikanizmin e Bacës Adem e që nuk ishte fare e vërtetë. Po në këtë bazë Ibrahim Rugova krijoi një mit me të cilin, duke u mbështjell me pëlhurën e një amerikanizmi dhe miqësie të përjetshme që e cilësonte si partneritet strategjik, e bëri një dallim me të tjerët duke e shndërruar në një moto të veprimit politik me të cilin lehtësisht i fitonte zgjedhjet ndonëse kishte mungesë kronike të aktivizimit dhe marrjes së përgjegjësive për postin që e mbante. Sidomos kjo ishte e theksuar pas përfundimit të luftës deri në kohën kur ndërroi jetë. Udhëheqësit e UÇK-së, ndonëse deklaroheshin pro-amerikanë, thuaja asnjëherë nuk e fituan besimin e plotë të amerikanëve dhe aleatëve të tjerë, madje e pësuan nga po këta aleatë të çastit. Pastaj, loja me pro-amerikanizëm dhe anti-amerikanizëm ka vazhduar sidomos pas daljes në skenë të LV-së, tash parti në pushtet dhe me pushtet absolut e që nuk është shumë larg diktatures. Lufta kryesore kundër LV-së dhe Albin Kurtit bëhej duke e cilësuar si anti-amerikan dhe rrezikues i marrëdhënive me partnerë strategjikë. Kjo jo vetëm se nuk e dobësoi as LV-në e as Albin Kurtin, por i forcoi deri në masë që në zgjedhjet e fundit parlamentare fituan mbi 50 % të votave. Çuditërisht, e që nuk ka asnjë logjikë, opozita e tashme ende e këndon "Këngën e Mjellmës të anti-amerikanizmit të Albin Kurtit" duke e matë me numrin e takimeve, vizitave dhe takimeve që i ka Albin Kurti me amerikanët në Kosovë dhe mungesën e vizitave në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Politikisht është dështim strategjik i opozitës në vend se t'i përvijë mëngët dhe ta bëjë punën e opozitës së vërtetë. Tash, më në fund, Albin Kurti, kryeministër i Kosovës, duket se do ta realizojë vizitën në ShBA, bashkë me Vjosa Osmanin, presidenten përçarëse dhe jounifikuese. Tash po spekulohet për nivelin e takimeve dhe për temën në këto takime duke harruar se Kosova, si vend i vogël dhe me një buxhet social, në planin global e luan një rol të papërfillshëm. Jo vetëm Albin Kurti dhe Osmani, por edhe të gjithë paraardhësitë politikë nuk janë pyetur asgjë për proceset, por se kanë pranuar detyra dhe miqësia apo partneriteti me ndërkombëtarët është përkthyer në përqindjen e realizimit të

detyrave të caktuara nga ndërkombëtarët. Ky ka qenë kusht i mbijetesës politike i udhëheqësve kosovarë dhe ky kusht vlen edhe për Albin Kurtin dhe Vjosa Osmanin, pa asnjë dyshim. Madje jam shumë i sigurt se kryeministri dhe presidentja, pra Albin Kurti dhe Vjosa Osmani, e kanë të qartë se çka do të kërkohet nga ata në këto takime dhe se nuk kanë shumë hapësirë manovruese. Kjo është ajo çka ndodh brenda takimeve, kurse fjalët e forta që fliten para medieve apo për opinion janë për përdorim të brendshëm e që nuk çojnë fare peshë. Të drejtën e përdorimit të fjalëve të forta dhe premtiveve, gjithashtu të forta, e kanë pasur edhe liderët e mëparshëm. Rezultatet janë të njohura. Albin Kurti, ose do të vallëzojë sipas muzikës amerikane dhe evropiane ose do të largohet nga skena politike. Nuk ka ndonjë mundësi tjetër. Sikur edhe të tjerët. Për aq sa shihet, Albin Kurti me asnjë çmim nuk do të largohet nga pushteti vullnetarisht, prandaj edhe do të vallëzojë sipas kësaj muzike! Pretekst për vizitë e kanë pjesëmarrjen në varrim të ish-sekretares së shtetit, Medllin Ollbrajt, që ndërroi jetë kohë më parë. Nga Kosova deri më tani janë konfirmuar se do të marrin pjesë në varrim, me lejen dhe kërkesën e familjes Ollbrajt, Vjosa Osmani, presidente aktuale, Atifete Jahjaga, ish-presidente dhe Albin Kurti, kryeministër i Kosovës. Nivel shumë përfaqësues. Mendja ma thotë se pjesëmarrja në varrim të sekretares së shtetit, Medllin Ollbrajt, është vetëm pretekst, kurse qëllimi kryesor është që Departamenti i Shtetit të mësojë nga Albin Kurti dhe Vjosa Osmani se si ta ndalin luftën në Ukrainë, si të mposhtet Rusia dhe si të pengohet ndikimi rus në Ballkan dhe Evropë përmes instrumentalizimit të Serbisë aq më parë që prej fillimit të luftës në Ukrainë, Albin Kurti dhe Vjosa Osmani kryesisht janë marrë me Ukrainën duke ofruar receta për zgjidhje, kurse në mënyrë fakultative janë marrë me Kosovën. Me këtë po dëshmohet se liderët kosovarë, që nga përfundimi i luftës e deri më sot, në mungesë të autoritetit vendimmarrës, gjithmonë kanë përdorur armët e huaja politike për të mbijetuar politikisht. Duket se ky është fati i popujve të vegjël e që prodhojnë liderë megalomanë!

Bisedimet me Serbinë në tunelin e Sabatos: Kjo gjendje që është në marrëdhëniet midis Serbisë dhe Kosovës më së shumti iu përgjigjet Aleksandër Vuçiqit dhe Albin Kurtit. Aleks Ujku, pasi i fitoi zgjedhjet në Serbi bindshëm edhe

për një mandat mund ta vazhdojë ta luajë rolin e viktimes dhe vajtojës së Serbisë duke e fajësuar Kosovën për gjithçka, që nga beteja e Mëllenjave e deri më sot dhe se në këtë aspekt po i shitet malli shumë në tregun ndërkombëtar. Serbia nuk është aspak e interesuar për marrëveshje me Kosovën qoftë edhe nëse e merr veriu e Kosovës të cilin edhe ashtu e kontrollon. Serbia ka arritur dhe po ka sukses që Kosovën ta mbajë në gjendje të tensionimit dhe destabilizimit të përhershëm strategjik. Serbisë i përshtatet kjo gjendje në Kosovë edhe për 500 vjetët e ardhshëm. Edhe Albin Kurtit i duhet kjo gjendje për të fituar kohë deri sa të kapë çdo segment të jetës në Kosovë. Deri sa të ketë pushtet 100 % nën kontroll. Gjykata Speciale ia ka dhënë votën përcaktuese fitores së Albin Kurtit dhe, nëse ka interes politikë do ta mbajnë në pushtet edhe për 20 vjet të ardhshme, bashkë me këtë Çetën e Profetëve të analfabetëve politikë me të cilët i ka mbushur institucionet dhe mbetjet biologjike të ish-bashkëpunëtorëve të Jugosllavisë dhe Serbisë që janë shumë të shumuar në thuaja të gjitha institucionet. Do të ishte shumë me ineteres për publikun të bëhet publikë lista e dëshmitarëve të mbrojtur dhe bashkëpunues të Gjykatës Speciale për ta kuptuar më mirë dhe përfundimisht rolin e ndyrë të disa individëve në luftë për pushtet. Aktualisht Kosova nuk ka opozitë vepruese por, nëse i kthehem të kaluara të tjerë e kemi të qartë se aty ku nuk e keni prituri, kanë shpërthyer pakënaqësitë. Nëse vazhdohet me këtë represion institucional dhe hakmarrje politike dhe jo vetëm politike, Hanibalin (dhunën) pashmangshëm dhe vet do ta sillni te porta! A ka ma abnormale se kur një shtet bisedon me shtetin tjetër, skajshmërisht armiqtësor për rregullim të brendshëm siç është Zajebnica dhe a ka diçka më idioteske se kur bisedoni me një shtet për dukjen dhe përdorimin e tabelave të regjistrimit për vetura! Kështu bëhet shteti a?! Nëse një burokrat mashtrues si puna e Miroslav Lajçakut për një pagë mujore afërsisht 50,000 euro mund dhe luan me Kosovën dhe qytetarët e saj, kjo nuk vlen për një burokrat tjetër si puna e Besnik Bislimit të luajë me këtë! Për aq sa po bisedojnë për tabela, shtetet kanë zgjidhur marrëveshje më të mëdha politike dhe ushtarake.

Të gjithë për Ukrainën, futja Kosovës: A keni dëgjuar ndonjë intervistë apo paraqitje publike të presidentes dhe kryeministrit sikur edhe sufleres së Ministrisë për Punë të Jashtme e cila, duke bërë

punën e Sizifit ia ka futur vetes në kokë se është ministere për Punë të Jashtme e që nuk përmendet Ukraina, Rusia kriminale, Zielinski, sanksionet kundër Rosisë, ndikimit rus në Serbi dhe rrezikut për luftë të re në Kosovë etj.?! Nuk e gjeni! Fitohet përshtypja se nuk po lufton Ukraina me Rusinë por se në luftë është Kosova. Kjo frikë e imponuar nga një luftë eventuale është riciklim i doktrinës politike dhe ushtarake të Rugovës që thoshte se: "rrii urtë se Serbia në shtatërron me robë e me dhi...". Tash, qeveria aktuale, në vend se të merret me qytetarët e Kosovës dhe problemet që janë të shumta, tërë aktivitetin, kryesisht me ministra të baushtellës dhe disa ministra profesionalisht analfabetë po e zhvendosë problemin në Ukrainë. Po kush na pyet neve për Ukrainën, pashë Zotin. Pa asnjë konkurs, në shtëpinë e vetme publike me letra në Kosovë e quajtur RTK, u pranua në punë një gazetare e Ukrainës për të lënë edhe tre vende tjera të lira. Në ndërkohë fshesa eliminuese në këtë shtëpi publike po punon me të madhe për të fshirë një numër të gazetarëve e për t'u zëvendësuar me gazetarë të regjimit aktual. Qofshin edhe nga Ukraina! Ukraina nuk e pranon pavarësinë e Kosovës e as që do ta pranojë në të ardhmen. Këtë e bëri të qartë ambasadori i Ukrainës në Beograd disa herë. Më kujtohet se kur u ekzekutuan Arben Xhealdini dhe Mon Balaj, në kordonin prej 124 policëve të UNMIK-ut, para Teatrit Kombëtar, ky kordon përbëhej nga policë të Rumanisë dhe të Ukrainës. Isha dëshmitar okular, sepse isha, si vëzhgues prapa kordonit bashkë me Veton Elshanin ndërkaq para kordonit ishin Baca Adem Demaçi, Albin Kurti, Fexhrije, Shkëmb dhe Blin Shala, Avdullah Dërguti dhe të tjerë të LV-së. Oficeri ishte gjerman kurse urdhër për intervenim kundër protestuesve e ka dhënë një oficer amerikan. Ishte kjo skena e krimi! Mbete pa tekst kur lexova diku se Qeveria e Kosovës paska kërkuar që disa ekspertë të forenzikës dhe mjekoligjorë nga Kosova të dërgohen në Ukrainë. Mbase për të hetuar krimet e luftës në kohën kur në Kosovë nuk e kanë lënë asnjë rast të krimeve të luftës pa e zgjidhur! Lavdi marrëzisë! Po më duhet ta përkrahë një vendim të kësaj qeverie; emërimin e Agon Vrenezit ambasador në sulltanatin e Erdoganit. Po lexoj se ka kritika shkaku se Agoni qenka mik i Mytes dhe Hajrullah Çekos. Agon Vrenezi është person i kompletuar në aspektin njerëzor, moral dhe kombëtar, jo për ta mbikëqyrur dhe drejtuar Ambasadën e Kosovës në Turqi, por edhe për ta drejtuar Ministrinë për Punë të Jashtme. Më së paku!

Osmani me shoqërinë civile: Kryeprokurori i Shtetit duhet të ketë integritet të dëshmuar përgjatë karrierës

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 21 PRILL - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur të enjten në takim përfaqësuesit e shoqërisë civile, me të cilët ka diskutuar për procesin e përzgjedhjes së kryeprokurorit të shtetit.

Presidentja Osmani i ka falënderuar përfaqësuesit e shoqërisë civile për pjesëmarrjen aktive në monitorimin e procesit të përzgjedhjes së kryeprokurorit të shtetit, duke nënvizuar se çdo rekomandim i identifikuar përgjatë procesit do të shqyrtohet me kujdes të veçantë. “Është thelbësore që çdo emërim të jetë rezultat i një procesi transparent dhe të drejtë, dhe çdo kandidat të ketë integritet të dëshmuar

përgjatë karrierës. Këto janë parime themelore të cilat i kam ndjekur në çdo emërim që kam bërë”, ka thënë presidentja Osmani.

Është bërë me dije se presidentja Osmani do t'i vazhdojë konsultimet edhe me aktorë të tjerë të përfshirë në këtë proces për t'u siguruar që procesi ka qenë i drejtë dhe i pranueshëm.

Më 6 prill Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) nominoi Blerim Isufajn për pozitën e kryeprokurorit të shtetit. Emri i tij duhet të dekretohet nga presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani.

Bashkimi Evropian ka shprehur zhgënjim me procedurën e përzgjedhjes së kandidatit për kryeprokuror të shtetit. “Pavarësisht prej thirrjeve të



vazhdueshme për të siguruar një përzgjedhje fer, transparente dhe të bazuar në merita, të kryeprokurorit të shtetit, Këshilli Prokurorial i Kosovës e përmbylli procesin duke mos i respektuar këto parime. I befashuar dhe i zhgënjyer me veprimet e KPK-së”, ka reaguar Szunyog në “Twitter”.

Edhe ambasadori gjerman në Prishtinë, Jorn Rohde, po ashtu ka shprehur zhgënjimin për vendimin e KPK-së, duke thënë se kjo nuk është mënyra e “duhur për të ecur përpara”. Organizatat që merren me monitorimin e sistemit të drejtësisë kanë reaguar pas votimit unanimit nga KPK-ja për Isufajn.

Pas këtyre ka reaguar edhe ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, Jeff Hovenier, duke thënë se fakti që anëtarët e KPK-së nuk i kanë marrë parasysh ankesat legjitime dhe rekomandimet e panelit shqyrtues

bien ndesh me atë standard. “Përfaqësuesit ndërkombëtarë, përfshirë anëtarët të Ambasadës së ShBA-së, u ftuan të marrin pjesë në procedurat e Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK) më 6 prill për ta zgjedhur kryeprokurorin e ardhshëm të shtetit. Prania jonë si vëzhgues nuk duhet të konsiderohet si miratim i procesit apo procedimit. Në disa raste Shtetet e Bashkuara kanë shprehur pritshmëri për procesin e përzgjedhjes së kryeprokurorit të ardhshëm të shtetit, të cilat ne besojmë se i ndajmë me qytetarët e Kosovës që: të jetë i drejtë, objektiv, transparent dhe i bazuar në merita. Fakti që anëtarët e KPK-së nuk i kanë marrë parasysh ankesat legjitime dhe rekomandimet e panelit shqyrtues, bie ndesh me atë standard”, ka theksuar ambasadori Hovenier, duke theksuar se Shtetet e Bashkuara nuk kishin një kandidat

të preferuar dhe as nuk gjykonin kualifikimet e kandidatëve individualë. “Jemi të shqetësuar se mënyra se si KPK i ka zhvilluar këto procedura ka dëmtuar besimin e publikut kosovar dhe besimin tonë në KPK si institucion publik”, ka pohuar Hovenier.

Nëpërmjet një reagimi të përbashkët, Instituti i Kosovës për Drejtësi, Grupi për Studime Juridike dhe Politike dhe Lëvizja FOL thanë se që prej mesit të marsit kanë publikuar një raport për shkelje gjatë procesit vlerësues të kandidatëve për kryeprokuror. Këto organizata kanë theksuar se paneli vlerësues i kishte vlerësuar kandidatët në mënyrë të pabazuar “duke cenuar meritokracinë e procesit”.

Kryeprokurori i shtetit është pozitë e rëndësishme në sistemin e drejtësisë së Kosovës. Kjo pozitë ka një mandat prej shtatë vjetësh.

Besim Kelmendi caktohet ushtrues detyre i kryeprokurorit të shtetit

Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) të enjten me votim unanimit ka caktuar prokurorin Besim Kelmendi, ushtrues detyre i kryeprokurorit të shtetit. Këtë detyrë Kelmendi do ta ushtrojë deri në një vendim të ri të KPK-së. Sipas Rregullores nr. 06/2019 për emërimin e kryeprokurorit të shtetit dhe kryeprokurorëve të prokurorive të Republikës së Kosovës, në qoftë se mandati i kryeprokurorit të prokurorisë përkatëse ka përfunduar në çfarëdo mënyre, KPK-ja merr vendim për caktimin e ushtruesit të detyrës.

Droga nga Shqipëria nëpërmjet Kosovës niset drejt Serbisë, kërkohet paraburgim për gjashtë të dyshuar

PRIZREN, 21 PRILL (ER) - Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti i Krimeve të Rënda, ka kërkuar caktimin e masës së paraburgimit nga Gjykata Themelore në Prizren ndaj të pandehurve: S. B., B. R., Gj. R., (shtetas të Republikës së Shqipërisë) dhe N. M., A. M. (1991) dhe A. M. (1999), (shtetas të Republikës së Kosovës), të cilët gjenden në ndalim 48 orësh nga data 20 prill.

Prokuroria Themelore në Prizren ka njoftuar se lidhur me këtë rast arrestimi i gjashtë të pandehurve të lartcekur ka ardhur si rrjedhojë e një hetimi disamujor në bashkëpunim të plotë me Policinë e Kosovës. “Sipas kërkesës së prokurorisë, me datë 20.04.2022 të pandehurit blejnë ose posedojnë pa autorizim, me qëllim të shitjes, shpërndajnë ose ofrojnë për shitje dhe importojnë substanca apo preparate të shpallura me ligj si narkotikë, në atë mënyrë që me marrëveshje



paraprake dhe në mënyrë të organizuar i ndajnë rolet. Në këtë mënyrë i pandehuri Gj. R. u shet substanca narkotike të llojit marijuanë të pandehurve N. M., A. M., dhe A. M., të cilën substancë narkotike, me automjetin e tipit ‘Mercedes’, me targa të regjistrimit të Republikës së Shqipërisë, e transporton nga Shqipëria në Kosovë tek i

pandehuri B. R., ku rreth orës 06:30 minuta e kalon pikën kufitare të Vërmicës, i cili më pas në fshatin Vaganicë të komunës së Mitrovicës takohet me të pandehurin N. M., bashkërisht hyjnë në garazhin e shtëpisë së të pandehurit N. M. për ta dorëzuar substancën narkotike, ku kapen në flagrancë të dy të pandehurit”, ka njoftuar Prokuroria Themelore

në Prizren.

Sipas këtij njoftimi, gjatë kontrollit në automjetin ‘Mercedes’, me targa të regjistrimit të Republikës së Shqipërisë, në bunkerin special të automjetit, policia gjen 10,583 kilogramë substancë narkotike e dyshuar për marijuanë, në garazhin e shtëpisë, pronë e të pandehurit N. M., policia gjen dy thasë të najlonit në 12, gjegjësisht 15 paketime, me peshë 18 kilogramë e 905 gramë dhe 12 kilogramë e 206.7 gramë, të cilën të pandehurit N. M., A. M., dhe A. M. do ta transportonin në Serbi. Sipas këtij njoftimi, “i pandehuri S. B. marijuanën e marrë nga Gj. R., me automjetin e tipit ‘Mercedes’, po ashtu me targa të regjistrimit të Republikës së Shqipërisë, e transporton nga Shqipëria në Kosovë, ku rreth orës 05:40 minuta e kalon pikën kufitare të Vërmicës, me destinacion të arrijë në Prishtinë, e kur arrin në lagjen ‘Uglar’ të

Fushë-Kosovës, ndalohe nga policia, e cila, gjatë kontrollit të automjetit, në bunkerin e modifikuar të tij, gjen 10,072 kg substancë të dyshuar narkotike të llojit marijuanë, të destinuar për tregun e Prishtinës”.

Me këto veprime, në cilësinë e bashkëkryerësve, të dyshuarit do të kryenin veprën penale “Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge” nga neni 267 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Prokuroria Themelore në Prizren ka njoftuar se në cilësi të provave materiale janë sekuestruar: Substanca e dyshuar narkotike e llojit marijuanë, tri vetura të tipit “Mercedes” (dy me targa të Shqipërisë, një me targa vendore, që të tria me bunker të modifikuar në të njëjtën mënyrë), shtatë telefona celularë, 10 507 euro si dhe disa monedha lekë të Shqipërisë dhe denarë të Serbisë.

Hapet aplikimi për shtesën 100 euro për punëtorët e sektorit privat

**EPOKA
ERE** **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 21 PRILL - Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ka hapur të enjten formën e aplikimit për mbështetje me 100 euro për punëtorët që nuk marrin pagë nga buxheti i shtetit.

Aplikimi për mbështetje do të bëhet në mënyrë elektronike përmes Administratës Tatimore të Kosovës (ATK). "Të dhënat duhet të jenë të sakta, dhe llogaria

bankare duhet të jetë në emër të përfituesit. Përndryshe, nëse të dhënat e plotësuara janë të pasakta, përfshirë numrin e llogarisë bankare, atëherë aplikuesi nuk do të mund të përfitojë nga subvencionimi", ka njoftuar Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

Kusht për kualifikim për mbështetje nga kjo masë është që punëtori të ketë qenë i deklaruar si i punësuar në periudhën tatimore shkurt 2022.

Punëtorët të cilët janë deklaruar

nga punëdhënësi në periudhën tatimore mars 2022 mund të aplikojnë, mirëpo subvencionin do të mund ta përfitojnë vetëm pasi të jenë deklaruar edhe për periudhat tatimore prill dhe maj, që nënkupton se subvencionin do të mund ta marrin në fund të muajit qershor 2022.

Ndërkaq të punësuarit e sektorit publik që marrin pagë nga buxheti i shtetit nuk kanë nevojë të aplikojnë sepse subvencionin prej 100 eurosh do ta marrin me pagën e muajit prill.



Mbahet Forumi Ekonomik Kosovë - Austri, theksohet bashkëpunimi në biznes



PRISHTINË, 21 PRILL (ER) - Të enjten është mbajtur Forumi Ekonomik Kosovë - Austri, në të cilin është theksuar bashkëpunimi i kompanive të dyja vendeve për të bërë biznes. Në këtë forum ka marrë pjesë edhe kryeministri Albin Kurti, i cili e ka falënderuar Ambasadën e Austrisë në Kosovë për këtë organizim. Ai ka theksuar se është kënaqësi të shohim se si kompanitë austriake interesohen

për ato në Kosovë. "Republika e Kosovës është falënderuese për mbështetjen e Austrisë në shumë fusha", ka thënë ai.

Kurti ka thënë se, sipas raportit të Bankës Botërore të të Bërit Biznes, Kosova ka bërë përparim të rëndësishëm në lehtësimin e procedurave për bizneset dhe të bërit biznes. "Ndërkaq, sipas raportit më të ri të 'Freedom House', Kosova është i vetmi vend

në Ballkanin Perëndimor që ka shënuar përmirësim të rezultatit të demokracisë", ka veçuar kryeministri Kurti, duke shtuar se: "Nëse keni qenë hezitues deri tani për të bërë biznes në Kosovë, mund t'ju siguroj se disa prej faktorëve kryesorë kanë ndryshuar dhe janë duke u reformuar për t'u bërë sa më miqësorë me bizneset", ka theksuar kryeministri Kurti.

Ministri Peci: Sigurime bujqësore për një sektor më konkurrues

PRISHTINË, 21 PRILL (ER) - Sigurimi i prodhimit bujqësor është segment shumë i rëndësishëm për ta zhvilluar dhe avancuar sektorin e bujqësisë edhe më tej dhe për ta bërë atë më konkurrues, është shprehur ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Faton Peci, në tryezën me temën "Sigurimi i bujqësisë - rritje e bujqësisë së Kosovës duke menaxhuar rreziqet e motit", e cila është organizuar nga MBPZHR-ja dhe Korporata Ndërkombëtare Financiare - IFC, anëtare e Grupit të Bankës Botërore. Me këtë rast, ministri Peci ka prezantuar politikën e reja bujqësore përmes të cilave ka theksuar se do t'i kontribuojnë zhvillimit dhe fuqizimit të sektorit të bujqësisë në Kosovë.

Në kuadër të Programit të Pagesave Direkte të vitit 2022, ministri ka njoftuar se do të mbështetën fermerët për subvencionimin e primit të

sigurimit bujqësor për 12 kultura bujqësore. "Ministria e Bujqësisë mbetet e vendosur që të mbështesë rritjen dhe zgjerimin e sektorit të sigurimeve bujqësore në Kosovë. Ne do ta vazhdojmë Programin e Pagesave Direkte. Kemi prezantuar subvencionimin prej 75 % të primës së sigurimit për sigurimet bujqësore dhe presim që të kemi rritje të numrit të fermerëve të cilët sigurojnë prodhimet e tyre kundër rreziqeve të motit", ka thënë Peci.

Ndër të tjera, ai ka shprehur gatishmërinë ta vazhdojnë bashkëpunimin me IFC-në, të cilën ai i ka falënderuar për përkrahjen e ofruar për funksionalizimin e sistemit për sigurime bujqësore.

Përqindja për subvencionim të sigurimeve bujqësore ka pasur rritje nga 50 % sa ishte në vitet 2020 dhe 2021, si dhe 75 % për vitin 2022, me qëllim që sigurimet bujqësore të jenë të



përballeshme për të gjithë fermerët të cilët do t'i sigurojnë produktet e tyre duke paguar

vetëm 25 % të vlerës së primës së sigurimit. Ndërkaq, që nga viti 2017, kur projekti i IFC-së për

Sigurime Bujqësore ka filluar të zbatohet në Kosovë, janë krijuar 15 produkte të sigurimeve bujqësore.

Më 26 prill hapet aplikimi për subvencione bujqësore

PRISHTINË, 21 PRILL (ER) - Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Faton Peci, ka njoftuar se më 26 prill hapet aplikimi "programi për pagesa direkte për subvencione 2022". Peci në llogarinë e vet në

"Facebook" ka thënë se ky program përmban rritje substanciale të mbështetjes financiare për fermerët me vlerë prej rreth 50 milionë euro duke përfshirë: 5 milionë euro subvencionim për naftën,

përkthyer në 0.36 cent për liter dhe 8 milionë euro për inputet bujqësore për plehërim pranveror për katër kultura bujqësore: 150 euro për hektarë grurë, misër, patate dhe për fasule 100 euro për hektar.



Lufta në Ukrainë e ka trazuar Ballkanin, çfarë duhet të bëjnë BE dhe SHBA



Nga Dejana SARIC & Pierre MORCOS
"Center for Strategic and International Studies"

Ndërsa lufta e Rusisë në Ukrainë po vazhdon në muajin e saj të dytë, një shqetësim i madh ka lindur në të gjithë rajonin e Ballkanit Perëndimor. Imazhet që vijnë nga Ukraina, kanë ringjallur kujtimet e tmerreve që përjetoi rajoni në vitet 1990, sidomos në Bosnje Hercegovinë dhe Kosovë.

Duke pasur parasysh lidhjet e forta ekonomike, ushtarake, dhe ato të fuqisë së butë të Rusisë, lufta aktuale ka ngritur shqetësime se Moska mund të përpiqet të destabilizojë më tej rajonin e Ballkanit, për ta shmangur vëmendjen nga fushata e saj ushtarake katastrofike në Ukrainë.

E etiketuar shpesh si "hallka më e dobët" e Evropës, Ballkani mund të shndërrohet në një burim të ri trazirash në një kontinent tashmë në kaos. Nën këtë sfond, Evropa dhe Shtetet e Bashkuara nuk mund të qëndrojnë duarkryq. Lufta në Ukrainë, ka ri-ngritur pyetjet mbi të ardhmen e integritit euroatlantik të rajonit.

Edhe pse i rrethuar nga shtetet anëtare të BE-së dhe NATO-s, rajoni mbetet vetëm pjesërisht i integruar në strukturat euro-atlantike politike dhe ato të sigurisë. Ndërsa vendeve në Ballkanin i kërkohet të marrin anë dhe të kontribuojnë në presionin diplomatik dhe ekonomik ndaj Rusisë, Evropa dhe Shtetet e Bashkuara duhet ta dyfishojnë angazhimin e tyre ushtarak, politik dhe ekonomik në rajon.

Ndikimi aktual i Rusisë në Ballkanin Perëndimor mbetet i fortë. Investimi ekonomik i Rusisë në rajon, është i fokusuar në sektorë strategjikë si energjia, teksa Moska ka shfrytëzuar sistemet e patronazhit partiak dhe

korrupsionit.

Gjatë viteve të fundit, Rusia i ka forcuar lidhjet e saj ushtarake me Serbinë, duke i shitur asaj armë, avionë dhe sisteme të mbrojtjes ajrore. Por është besimi ortodoks i rusëve, dhe kundërshtimi i vazhdueshëm i Rusisë ndaj pavarësisë së Kosovës, ai që hedhur themelet për fuqinë e saj të butë në rajon.

Kjo qasje i ka hapur rrugën depërtimit të fuqishëm të ndikimit rus në Serbi, Bosnjë dhe në Malin e Zi, ku segmente të rëndësishme të politikës janë shumë pro-ruse. Për udhëheqës si Aleksandar Vucic në Serbi dhe Milorad Dodik në Bosnje, lidhjet e ngushta me udhëheqjen ruse janë një çështje e mbijetesës politike.

Që nga fillimi i pushtimit rus të Ukrainës në shkurt, parë në Serbi, Malin e Zi dhe Bosnje janë parë tubime pro-ruse nga grupimet e ekstremit të djathtë me lidhje direkte me Rusinë. Për fraksionet nacionaliste në mbarë rajonin, që e shohin Rusinë e Putinit si një mbrojtëse të ortodoksëve, pushtimi nga Rusia i një vendi ortodoks si Ukraina nuk është një kontradiktë shumë e madhe.

Të ndarë nga konteksti historik, këto grupe e shohin Rusinë si rikuperuese të një territori që i përket me të drejtë i rusëve, ashtu siç do të dëshironin ta shihnin Kosovën të "rikthyer" nën kontrollin e Serbisë. Vetë Putin e ka përmendur shpesh shembullin e Kosovës si një justifikim për aneksimin e Krimesë nga Rusia dhe të sulmeve të saj në Donetsk dhe Luhansk. Ashtu si Ukrainën, Rusia e sheh Ballkanin Perëndimor si një zonë tampon, ku mund të ruajë një sferë ndikimi dhe të dëmtojë Perëndimin.

Në Malin e Zi, operativët rusë të FSB-së dhe GRU-së ishin në mesin e atyre që u arrestuan për shkak të një përpjekjeje të dështuar për grusht shteti në vitin 2016, që synonte të pengonte anëtarësimin e Malit të Zi

në NATO. Sa i përket Kosovës dhe Serbisë, mbështetja e Rusisë ndaj kësaj të fundit i minon përpjekjet për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet dy vendeve.

Kjo gjë e pengon edhe integrimin e të dyjave në Bashkimin Evropian. Ndërkohë kërcënimet e fundit të Rusisë për të vendosur veton ndaj ripërtëritjes të mandatit të forcës paqeruajtëse të BE-së në Bosnje, e kanë nënvizuar brishtësinë e kushtetutës së pasluftës në këtë vend.

Në të gjitha këto raste, Rusia ka treguar se mund të destabilizojë shumë lehtë Ballkanin. Pushtimi rus i Ukrainës i ka thelluar ndarjet midis zërave pro-perëndimorë dhe pro-rusë në të gjithë rajonin. Anëtarët e NATO-s, Shqipëria, Kroacia, Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut u rreshtuan me shpejtësi me sanksionet e BE-së, ashtu siç bëri edhe Kosova që aspiron të bëhet pjesë e NATO-s.

Ndonëse mbështesin rezolutat e OKB-së që dënojnë veprimet e Rusisë, Serbia dhe Bosnja kanë refuzuar t'i bashkohen sanksioneve kundër Rusisë, duke u bërë kështu dy vendet e vetme evropiane që mbeten jashtë listës së shteteve "armiçësore" të Rusisë.

Në Bosnje është shumë e përhapur frika, se lufta në Ukrainë mund të sjellë destabilitet në Ballkan. Pamundësia për të pasur një pozicion të përbashkët në dënimin e sulmit të Rusisë ndaj Ukrainës, vjen për shkak të sjelljes pro-ruse të Dodik, anëtarit serb të presidencës trepalëshe të vendit.

Bosnja ndodhet muajt e fundit në krizën e saj më të rëndë të pasluftës, pikërisht për shkak të kërcënimeve të Dodik për tërheqjen nga institucionet federale të entitetit me shumicë serbe. Menjëherë pas pushtimit rus të Ukrainës, ambasadori rus në Bosnje i nxiti këto frikëra duke paralajmëruar se çdo afirim midis Bosnjës dhe NATO-s, do të sillte një reagim të Moskës, duke thënë: "Shembulli i Ukrainës,

tregon atë që pritet të ndodhë!"

Në Kosovë, ku ndjenjat e qytetarëve janë shumë pro-perëndimore dhe anti-ruse, kriza në Ukrainë ka rritur shqetësimet për sigurinë. Udhëheqësit e qeverisë, kanë kërkuar një rrugë më të shpejtë drejt anëtarësimit në NATO dhe një bazë të përhershme në NATO.

Edhe pse Mali i Zi u bashkua me shpejtësi sanksioneve kundër Rusisë, ai nuk i ka zbatuar ende shumicën e tyre për shkak të grindjeve politike të brendshme. Qeveria pro-serbe e vendit, e cila u rrëzua pas një mocioni mosbesimi në muajin shkurt, por që mbetet ende në një rol kujdestar, është shumë e përcarë mbi sanksionet.

Dhe kjo ndarje zbulon edhe shkallën e ekspozimit ekonomik të vendit: Rusia është investitorja më e madhe e huaj direkte në Malin e Zi, duke investuar shumë në tregun e saj të pasurive të paluajtshme dhe në sektorë si metalurgjia.

Por nëse negociatat do të kenë sukses, një qeverie e re e udhëhequr nga pakica që do të formohet nga kryeministri i emëruar Dritan Abazovic i bllokut pro-perëndimor Bardh e Zi, mund të zbehtë zërat pro-rusë që janë aktualisht në qeveri.

Vëmendja e Perëndimit është e përqendruar kryesisht në Serbi, ku lufta në Ukrainë përbën një sfidë shtesë për qeverinë, teksa ajo po përpriqet të luante një rol balancues midis Rusisë dhe Perëndimit përpara zgjedhjeve presidenciale, parlamentare dhe lokale të 3 prillit. Në kushtet kur popullata i mban mend mirë kostot e sanksioneve perëndimore, presidenti Vucic është përpjekur ta portretizojë veten si kandidati më i aftë për të mbrojtur stabilitetin e Serbisë. I vetëdijshëm për një ndjenjë të fortë pro-ruse në vend, dhe për një kontroll të shtuar të BE-së dhe SHBA-së, Vucic ka qenë i bindur për rolin neutral të Serbisë në këtë krizë.

Serbia votoi pro dënimin të pushtimit rus të Ukrainës nga

Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, por refuzoi të rreshtohet me sanksionet e BE-së ndaj Rusisë. Pritet që fitorja të ndryshojë këtë ekuilibër, por nuk është e garantuar se Vucic do të anojë nga Perëndimi, sidomos tani që qeveria do të nisë negociatat për koalicionin e ri qeverisës.

Në këtë kontekst, Evropa dhe Shtetet e Bashkuara duhet të dyfishojnë përpjekjet e tyre për të shmangur destabilizimin e mëtejshëm në Ballkan. Në varësi të reagimit perëndimor, dy të ardhme shumë të ndryshme e presin rajonin: ose një destabilitet në rritje, të cilën mund ta shfrytëzojë Rusia, ose një integrim afatgjatë brenda komunitetit evropian.

Pas vitesh ngërçi, lufta brutale në Ukrainë po i detyron të gjithë aktorët të zgjedhin një rrugë të qartë politike, si dhe të marrin vendime të guximshme. Muajt e ardhshëm do të ofrojnë mundësinë për të diskutuar mbi të ardhmen e rajonit, duke filluar me një samit evropian kushtuar Ballkanit Perëndimor në qershor, organizuar nga Franca, si drejtuese e radhës e presidencës së BE-së.

Në nivel politik, është e domosdoshme që Evropa t'i përgjigjet thirrjeve në të gjithë rajonin për të përshpejtuar integrimin në BE në kontekstin e luftës në Ukrainë. Një proces i ringjallur i anëtarësimin, do të nxiste përparimin në reformat shumë të nevojshme të qeverisjes dhe sundimit të ligjit në këto vende.

Ndërkohë, duhet që Bashkimi Evropian dhe NATO të rrisin mbështetjen e tyre për të ndihmuar vendet e Ballkanit Perëndimor në forcimin e sundimit të ligjit dhe kundërshtimin e ndikimit dashakeq të Rusisë. Nga ana tjetër, udhëheqësit rajonalë duhet të bëjnë një bilanc të së ardhmes që duan të ndërtojnë për vendet e tyre.

Marrë me shkurtime



**QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

Peja shpallet kampione e Ligës Unike

PEJË, 21 PRILL - KB Peja ka mundur KB Golden Eagle Ylli me rezultat 72:87 (19:23, 15:26, 19:20, 19:18), për tu shpallur për herë të parë kampion i Ligës Unike.

Në një spektakël të madh të basketbollit, pikërisht në Pejë, verdhezinjtë arritën trofeun e parë për këtë edicion. Nga fillimi i ndeshjes të dy skuadrat e deshën shumë fitoren dhe trofeun e çmuar, duke e bërë ndeshjen shumë interesante.

Fillimi i kësaj sfide ishte i barabartë, kurse më pas pejanët kishin epërsi deri në shtatë pikë, 16:23, ndërsa çereku i parë përfundoi 19:23. Dallimi i madh u bë në periudhën e dytë, kur pejanët të përkrahur nga tifozët vendas, ngritën epërsinë minutë pas minute, duke shkuar në pushim me shifrat 34:49. Në periodën e tretë, therandasit u munduan të bëjnë rikthimin e madh, ndërsa skuadra pejane ruajti epërsinë, që kohë pas kohe e

ngriti, kurse rezultati në semafor pas 30 minutash ishte 53:69. Edhe në dhjetë minutat e fundit u zhvillua lojë e barabartë dhe kjo mjaftoi që të shpallet kampion i Ligës Unike. MVP është shpallur Dardan Berisha, çmim të cilin ia ndau Sekretarja e Përgjithshme e FBK-së, Elvira Dushku dhe Sekretari i Përgjithshëm i FBSH-së, Korab Llazani. Ndërkohë, trofeun e kupës, Berishës, ia kanë dorëzuar kryetari i FBK-së, Arben Fetahu dhe kryetari i Bordit Drejtues të Ligës Unike, Ilir Trebicka.

Prizrenit 16 i takon vendin i tretë

Prizreni 16 ka mundur Teutën e Durrësit me rezultat 89:106 (21:16, 22:30, 17:28, 29:32), për të zënë vendin e tretë në Ligën Unike. Fillimi i ndeshjes ishte i barabartë, por më pas durrsakët ishin më të mirë, duke pasur epërsi deri në



tetë pikë, 21:13, ndërsa çereku i parë përfundon 21:16. Prizrenasit u kundërpërgjigjën në periudhën e dytë, ku arritën të barazojnë shifrat dhe shkuan në pushim me shifrat 43:46. Basketbollistët

nga Prizreni ishin edhe më të mirë në periodën e tretë, për të thelluar epërsinë, ndërsa shifrat pas 30 minutash ishin 60:74. Dhjetë minutat e fundit ishin kryesisht të barabartë dhe Prizreni 16 fitoi 89:106. Fatmir Gashi,

kryetar i KB Peja i dorëzoi çmimin Fair Play, kapitenit të Teutës, Kristi Gorea. Gashi dhe Blerim Vuniqi, anëtar i Bordit Drejtues të Ligës Unike kanë ndarë medaljet e bronzte për klubin e Prizrenit 16.

Kryetari i Prishtinës pret në takim drejtuesit e FFK-së



PRISHTINËS, 21 PRILL - Kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, ka pritur sot presidentin e FFK-së, Agim Ademi, i cili ishte i shoqëruar nga anëtar i KE-s, njëherësh kryetari i LRF të Prishtinës, Ismajl Ajeti, ushtruesi i detyrës së sekretarit të përgjithshëm, Taulant Hodaj dhe kryetari i grupit të tifozëve "Dardanët", Lulzim Berisha. Gjatë këtij takimi u diskutuan çështje të

ndryshme sa i përket bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve, veçmas për përmirësimin e infrastrukturës së futbollit në kryeqytet. "Projekti për rritjen e kapacitetit të stadiumit 'Fadil Vokrri', dhënia e parcelave për ndërtimin e fushave të klubeve të kryeqytetit (Flamurtarit e Hajvalisë), si dhe parcela për ndërtimin e fushës dhe zyrave të LRF të

Prishtinës, si dhe realizimi i projektit për futbollin në shkolla, ishin temat kryesore të këtij takimi, për të cilat të dyja palët janë pajtuar plotësisht. Si rrjedhojë në të ardhmen e afërt do të bëhet edhe nënshkrimi i Memorandumit të Bashkëpunimit nëpërmjet të cilit do të parashihet realizimi i secilit projekt", thuhet në njoftimin e Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK).

Trajneri i Reims: Zeneli është lojtar i rëndësishëm për ne

LILLE, 21 PRILL - Ylli i Përfaqësueses së Kosovës, Arbër Zeneli, u rikthye të mërkurën titullar tek ekipi i tij, Stade de Reims. Anësori bëri paraqitje të mirë në fitoren e skuadrës së Lilles (2-1), për çka është lavdëruar edhe nga trajneri Oscar Garcia. "Ai është një lojtar që mund ta bëjë dallimin. Në

fazën ofensive ai mund të bëjë shumë gjëra dhe mjaft mirë. Ne punojmë me të sepse ai duhet të ndihmojë edhe kur nuk e kemi në posedim topin. Por, për momentin, fizikisht, ai nuk është i gatshëm t'i bëjë të dyja (fazën ofensive dhe defensive)", ka thënë trajneri i Reimsit. "Cila është arma e tij

e fortë? Një kundër një, ai shkon mjaft shpejt për ta kaluar lojtarin. E ka një goditje mjaft të mirë, e kemi parë këtë edhe nga gjuajtjet e lira. Kur e ka topin ai është mjaft i motivuar dhe ndihet rehat me topin dhe është mjaft i lëvizshëm. Ai është lojtar mjaft i rëndësishëm për ne", ka shtuar Garcia.



Vojvoda nuk e përjashton largimin nga Torino

TORINO, 21 PRILL - Mbrojtësi i Përfaqësueses së Kosovës në futboll, Mërgim Vojvoda, e ka tërhequr interesimin e skuadrës së Milanit. Mbrojtësi nga Drenica po shkëlqen me fanellën e

skuadrës së Torinos. Lidhur me të ardhmen e tij, Vojvoda për "RTKLive" ka thënë se vera është e gjatë dhe se mund të largohet klubi torinez. "Për momentin jam i përqëndruar vetëm në Torino

dhe do të fokusohem deri në ndeshjen e fundit. Ndihehem shumë i lumtur në Torino dhe klubi është i kënaqur me punën time. Torino është ekip me histori, klub i madh në Serinë A. Por në

futboll gjërat mund të ndryshojnë shumë shpejt dhe vera është e gjatë", ka thënë Vojvoda, i cili është pjesë e Torinos nga viti 2020, duke regjistruar 42 paraqitje dhe shënuar dy gola.



Ten Hagen, trajner i ri i Unitedit

MANCHESTER, 21 PRILL - Erik ten Hag do të jetë trajner i Manchester Unitedit duke filluar nga 1 korriku 2022. Vetë "Djajtë e Kuq" e njoftuan këtë me një deklaratë zyrtare: "Manchester Unitedi është i lumtur ta shpallë Erik ten Hag trajnerin e ri të ekipit të parë nga 1 korriku 2022 deri në qershor 2025, me opsion për vazhdimin e mëtejshëm të kontratës. Marrëveshja do të hyjë në fuqi vetëm në fund të këtij sezoni sportiv, të cilin Ten Hag do ta mbyllë rregullisht në bankinën e Ajaxit dhe mbetet si zakonisht subjekt i marrjes së një leje pune për të qëndruar në Angli". Ndërsa trajneri Ten Hagen është shprehur shumë i lumtur se e ka marrë drejtimin e një skuadre të madhe siç është Manchester Unitedi. "Është një nder i madh të emërohem trajner i Manchester Unitedit. Ndihehem shumë i emocionuar për sfidën që më pret. Unë e njoh historinë e këtij klubi të madh dhe



pasionin e tifozëve, ndaj jam absolutisht i vendosur të zhvilloj një ekip të aftë për sukses. Do të jetë e vështirë të largohem nga Ajaxi pas këtyre viteve të pabesueshme, por mund t'i

siguroj tifozët tanë për angazhimin dhe fokusin tim të plotë për ta mbyllur këtë sezon me sa më shumë sukses, përpara se të transferohem te Manchester Unitedi", ka thënë Ten Hag.

Philadelphia, një hap larg gjysmëfinaleve, Chicago ndali kampionët e Milwaukeees

PHILADELPHIA, 21 PRILL - Philadelphia udhëheq 3-0 serinë e çerekfinaleve "play-off" ndaj Torontos pas fitores me rezultat 104-101 të arritur në fushën e ekipit kanadez. Ndeshje me rivalitet dhe emocione deri në fund, ku vendimtar për miqtë ishte Joel Embiid me 33 pikë e 13 rebounde, mbështetur edhe nga Hardeni e Maxey, me nga 19 pikë secili. Barazim 1-1 mes Chicagos e Milwaukeees, me Bulls-in që arritën një fitore të rëndësishme jashtë



fushës me shifrat 114-110. DeRozan me 41 pikë ishte lider në fushë për Chicagon, ndërsa Vuçevići realizoi 24 pikë e LaVine 20. Në kahun tjetër, Antetokounmpo realizoi 33 pikë e 18 rebounde për kampionët, por që mbetën për statistikë. Edhe sfida e tretë e "play-off"-it ishte e

Konferencës së Lindjes, ku Bostoni mposhti me rezultat 114-107 Brooklynin, duke shfrytëzuar në maksimum faktorin fushë. 7 lojtarë të Bostonit realizuan mbi 10 pikë, me Jeremy Brownin protagonist, autor i 22 pikëve (Durant 27 pikë për Nets). Celticsi udhëheq 2-0 serinë e ndeshjeve çerekfinale.

Konferenca e Lindjes - Çerekfinale "play-off"

Miami - Atlanta	(2-0)
Philadelphia - Toronto	104-101 (3-0)
Milwaukee - Chicago	110-114 (1-1)
Boston - Brooklyn	114-107 (2-0)

Konferenca e Perëndimit - Çerekfinale "play-off"

Phoenix - New Orleans	(1-1)
Dallas - Utah Jazz	(1-1)
Golden State - Denver	(2-0)
Memphis - Minnesota	(1-1)

Ten Hagen, trajner i ri i Unitedit

Manchester, 21 prill - Erik ten Hag do të jetë trajner i Manchester Unitedit duke filluar nga 1 korriku 2022. Vetë "Djajtë e Kuq" e njoftuan këtë me një deklaratë zyrtare: "Manchester Unitedi është i lumtur ta shpallë Erik ten Hag trajnerin e ri të ekipit të parë

nga 1 korriku 2022 deri në qershor 2025, me opsion për vazhdimin e mëtejshëm të kontratës. Marrëveshja do të hyjë në fuqi vetëm në fund të këtij sezoni sportiv, të cilin Ten Hag do ta mbyllë rregullisht në bankinën e Ajaxit dhe mbetet si zakonisht

subjekt i marrjes së një leje pune për të qëndruar në Angli". Ndërsa trajneri Ten Hagen është shprehur shumë i lumtur se e ka marrë drejtimin e një skuadre të madhe siç është Manchester Unitedi. "Është një nder i madh të emërohem trajner i Manchester

Unitedit. Ndihehem shumë i emocionuar për sfidën që më pret. Unë e njoh historinë e këtij klubi të madh dhe pasionin e tifozëve, ndaj jam absolutisht i vendosur të zhvilloj një ekip të aftë për sukses. Do të jetë e vështirë të largohem nga Ajaxi

pas këtyre viteve të pabesueshme, por mund t'i siguroj tifozët tanë për angazhimin dhe fokusin tim të plotë për ta mbyllur këtë sezon me sa më shumë sukses, përpara se të transferohem te Manchester Unitedi", ka thënë Ten Hag.

SHKURT

Guardiola: Nëse ne bëjmë një hap fals, Liverpooli do të jetë kampion

Manchester City mori një fitore 3-0 përballë Brightonit teksa u rikthye përsëri në krye të Premierë Ligës me një pikë më shumë se Liverpooli. Pas kësaj ndeshjeje trajneri i citizenëve, Pep Guardiola, e di shumë mirë se një gabim shumë i vogël do t'u kushtonte shumë "qytetarëve" në garën për titullin kampion, pasi "The Reds" është aty për të përfituar nga hapat fals të skuadrës së tij. "Ne nuk jemi budallenj, nëse barazojmë, humbim dy pikë dhe Liverpooli do të jetë kampion. Nëse i fitojmë të gjitha ndeshjet tona, ne do të jemi kampionë. Lojtarët e dinë këtë. Na presin ndeshje të vështira dhe ne duhet të përpiqemi të luajmë si sot dhe t'i fitojmë të gjitha. Nëse e bëjmë këtë, do të festojmë, nëse jo, do ta urojmë Liverpoolin", ka deklaruar Guardiola.

Erikseni, afër rikthimit në Tottenham

Përpara mbarimit të sezonit aktual Tottenham Hotspur po planifikon objektivat për sezonin e ardhshëm dhe një ndër ta është nënshkrimi me disa lojtarë të rinj në merkaton e verës. Mediet kanë raportuar se te Tottenhami do të ishin shumë të lumtur nëse do të ribashkoheshin me "yllin" danez Christian Eriksen. Rikthimi në shtëpinë e vjetër do të ishte emocionues edhe për vetë mesfushorin i cili ka luajtur me londinezët për gjashtë vjet e gjysmë, që prej vitit 2013 deri në janar të vitit 2020 kur u largua drejt Interit. Tashmë që Erikseni la pas problemet me shëndetin, duket se është i gatshëm të rikthehet te Tottenhami dhe të japë më të mirën në ekipin ku ka kaluar më shumë vite të karrierës së tij.

Tuchel: Humbëm nga gabimet tona

Trajneri i Chelseat, Thomas Tuchel, fajëson gabimet e shumta të skuadrës së tij për humbjen me Arsenalin. Trajneri gjerman ka vlerësuar se Chelsea bëri gabime të tilla edhe në ndeshjet e tjera kundër Realit të Madridit dhe Brentfordit. "U shënuan 6 gola dhe ne humbëm 4-2. Bëmë shumë gabime dhe e ftuam kundërshtarin të shënonte. Nuk më kujtohet ndonjë gabim në favorin tonë të këtij kalibri. Nuk i fitojmë ne këta gola, por i dhurojmë dhe e bëjmë në ndeshje radhazi. Fakti që barazuan dy herë dhe e hodhëm sërish ndeshjen në erë është zhgënjyes. Arsenalin e ndryshoi taktikën tri herë, provuam edhe ne. Por duke bërë gabime individuale dramatike si te goli i parë, i dytë dhe i katërt, është shumë e vështirë të luash kur i ke dhënë avantazhin 3-0 kundërshtarit. Këtë bëmë edhe ndaj Realit të Madridit dhe Brentfordit. Lukaku? Nuk më intereson të flas për paraqitje individuale pas paraqitjeve të tilla", ka thënë Tuchel.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se “LMMK” SH.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811449257 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “LMMK” D.O.O. Prishtinë donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811449257 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the “LMMK” L.L.C. Prishtinë has come to the decision to quit its business: 811449257 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LĒKARSKA KOMORA KOSOVA

Oda e Mjekëve të Kosovës – Kosovo Doctors Chamber – LĒkarska Komora Kosova

FTESË PËR OFERTË

Lloji i Kontratës: Furnizim Shërbime Punë

Nr. i Prokurimit 03-22

Oda e Mjekëve të Kosovës është organizatë e pavarur profesionale e mjekëve që ushtron veprimtari profesionale mjekësore në Republikën e Kosovës.

OMK anëtareve të saj, i siguron standarde të larta të kodit të etikës dhe deontologjisë mjekësore, promovon dhe mbrojnë veprimtarinë e profesionistëve shëndetësor në institucionet shëndetësore publike, private si dhe publiko-privatë, siguron edukimin e vazhdueshëm profesional me qëllim të ngritjes së performancës shëndetësore dhe ofrimit më cilësor të shërbimeve shëndetësore dhe shërbimeve tjera që kanë të bëjnë me kujdesin shëndetësor.

Oda e Mjekëve të Kosovës fton të gjitha kompanitë e interesuara që të paraqesin kërkesën e tyre për dosje të tenderit në adresën **Instituti A, Kati 2, QKUK, 10000 Prishtinë**, apo përmes emailit: **info@omk-rks.org**, me titullin:

Dosja për: Kontratë për furnizim me material shpenzues për zyret e OMK-së

Në pajtim me Nenin 8, paragrafin 1 të Rregullores për Procedurat e Prokurimit në OMK:

Afati për parashkrimin e ofertave është në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e publikimit, për Kontratën me vlerë të madhe (që tejkalojnë shumën prej 10,000.00 €).

Afati për parashkrimin e ofertave është në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) ditëve nga dita e publikimit, për Kontratën me vlerë të mesme (vlera e të cilave është deri në 10,000.00 €).

Njoftimin për kontratë mund ta shkarkoni në uebin e Odës: <https://omk-rks.org/>

Afatet Kohore.

Afati i fundit për tërheqje të dosjes së Tenderit është: **04.05.2022 ora 14:00.**

Afati i fundit për aplikim në Tender është: **06.05.2022 ora 12:00.**

Hapja e ofertave bëhet me datën: **06.05.2022 ora 14:00.**

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se “Arber&Joni” SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811343227 me seli në Fushë Kosovë dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Arber&Joni” D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811343227 Fushë Kosovë ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the “Arber&Joni” L.L.C. has come to the decision to quit its business: 811343227 Fushë Kosovë the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se “Gift Shop Accessories” SH.P.K. me seli në Obiliq, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811361683 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Gift Shop Accessories” D.O.O. Obiliq donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811361683 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the “Gift Shop Accessories” L.L.C. Obiliq has come to the decision to quit its business: 811361683 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM ZBRITJE MALLI DERI 75 %

Biznesi individual me numër Unik Identifikues 810497398 me seli në Llapna Sell dhe nr. kontakti 044777778, për arsye të likuiditetit, njofton të interesuarit qytetarë si persona fizik apo juridik mund të blejnë produkte kozmetike grimi të brendeve botërore MAX FACTOR, ARTDECO, parfuma, deodorante, qumësht trupi etj, të firmave botërore BOSS, BALDESSARINI, D&G, Lacoste, Moschino, Valentino, Versace, ngjyra flokësh, pajisje tretmani dhe mirëmbajtje floku të prodhuesit Italian DIKSON.

Lokali me qira

Lëshohet lokali me qira. Lokali ka 75 m2. Lokali gjendet tek "REB BULLI", në Prizren. Për informata mund të na kontaktoni në këta numra të telefonit: **044-514-373 dhe 044-199-707.**

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Arbonra Isufi, shpall të pavlefshme dëftesat e klasës -X-, -XI-, -XII- të shkollës së mesme të mjekësisë, SH.M.M "Hysni Zajmi", Gjakovë.
- ▶ Redon Ferizi shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit "Hajdar Dushi" si dhe dëftesat e klasës -X-, -XI- dhe -XII-të.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkohet një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- ▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- ▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- ▶ Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- ▶ Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- ▶ Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.
- ▶ Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.
- ▶ Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA
HALAL FOOD

PASHTETË PULE

gluten
free



100% mish pule



cilësi e garantuar

pa konservues